

VENDIM
Nr. 16, datë 12.4.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.37, DATË 13.7.2016, TË KOMITETIT PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE “PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE
TË GRANTIT “ARSIM”, THIRRJA E DYTË, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË
INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I, PËR VITIN 2016”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.37, datë 13.7.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit “Arsim”, thirrja e dytë, Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, për vitin 2016”, bëhen ndryshimet sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Financave dhe ministri i Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Në tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 37, datë 13.7.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit “Arsim”, thirrja e dytë, Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, për vitin 2016”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Tabela 1 Lista e projekteve të reja për financim, thirrja e dytë, përmes grantit “Arsim”, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, për vitin 2016.

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
QARKU ELBASAN					
1	Bashkia Gramsh	Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar “Refat Bani”	55,024,983	0	19,000,000
QARKU TIRANË					
6	Bashkia Tiranë	Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare “Kosova “ Tiranë	265,391,003	0	100,000,000
8	Bashkia Tiranë	Ndërtimi i sallës së koncerteve pranë auditorit të Liceut Artistik “Jordan Misja”	117,960,244	0	40,000,000

Shënim:

1. "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën e financimit të projektit, miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

2. “Vlera e financimit për vitin 2016” tregon vlerën e financimit të alokuar për vitin 2016, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në vitin 2016 dhe 2017.

3. “Vlera e financimit për vitin 2017” është financimi që jepet për vitin 2017, me burim fondin për projekte të reja, të programit buxhetor “Arsimi bazë” dhe “Arsimi i mesëm i përgjithshëm” të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për vitin 2017.

4. Likuidimi financiar për vlerën e projektit (ose për vlerën e kontratës pas prokurimit publik) në vitet në vazhdim do të kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, duke u bazuar edhe në ecurinë e zbatimit dhe të realizimit të projekteve, programuar në buxhet, me shtrirje në 2 vite.